

**RREGULLAT E LOJËS SHPËRBLYESE**  
**"EAST GATE MANIA"**

**Organizator i lojës shpërblyese**

**Neni 1**

Organizator i lojës shpërblyese **"EAST GATE MANIA"** është Shoqëria për Menaxhimin e Pasurive të Paluajtshme East Gate Mall, me seli në rrugën Bellasica nr. 2, Shkup, Gazi Babë, me NUT MK 4043019526203 dhe NUAS 7339046 referuar në tekstin e mëposhtëm: Organizatori).

**Emri i lojës shpërblyese**

**Neni 2**

Emri zyrtar i lojës shpërblyese është **"EAST GATE MANIA"**.

**Qëllimi i lojës shpërblyese**

**Neni 3**

Qëllimi i kësaj loje shpërblyese është reklamimi i prodhimeve dhe shërbimeve të organizatorit.

**Territori**

**Neni 4**

Loja shpërblyese do të organizohet dhe realizohet së bashku me subjektet shitëse në qendrën tregtare që kanë pikën e tyre të shitjes/degës në EAST GATE MALL sh.p.k import-eksport Shkup dhe të cilët marrin pjesë në të në përputhje me rregullat për pjesëmarrjen e një subjekti të shitjes.

## **E drejta për pjesëmarrje**

### **Neni 5**

Të drejtë pjesëmarrjeje në lojën shpërblyese kanë të gjithë qytetarët e moshës madhore në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilët do të blejnë prodhime në vlerë prej së paku 3000 denarë e më shumë nga subjektet shitëse (dyqanet) që janë pjesë e lojës shpërblyese.

Personat nën moshën 18 vjeç nuk mund të marrin pjesë në lojën shpërblyese.

Punëtorët e EAST GATE MALL, si dhe rrethi ngushtë i familjeve të tyre nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në lojën shpërblyese.

## **Kohëzgjatja e lojës shpërblyese**

### **Neni 6**

Loja shpërblyese do të nisë më datë 03.07.2023 dhe do të zgjasë deri më datë 31.08.2023. Brenda kësaj periudhe, konsumatorët mund të blejnë, mbledhin dhe dërgojnë numrat dhe datat e kuponëve fiskal në numrat special të telefonit për qëllim të mbledhjes së mesazheve.

## **Mekanizmi i lojës shpërblyese**

### **Neni 7**

Loja shpërblyese do të zgjasë nga data 03.07 (fillimi i dërgimit të mesazheve 00:01h) deri më datën 31.08.2023 (mbarimi i dërgimit të mesazheve në ditën e fundit është 23:59h).

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë konsumatorët që kanë blerë prodhime në vlerë prej 3.000 denarë e më lart (në pikën e shitjes në qendrën tregtare që merr pjesë në lojën shpërblyese), të cilat vërtetohen dhe dokumentohen me kupon fiskal.

Kuponi fiskal me vlerë të dyfishtë të minimumit të përcaktuar (6.000 denarë) nuk mund të konsiderohet si mundësi e dyfishtë për pjesëmarrje dhe konsumatori nuk ka të drejtë të luajë dy herë.

Konsumatorët e regjistrojnë pjesëmarrjen e tyre duke dërguar SMS mesazh në numrin e telefonit 148777 në dispozicion nga operatorët A1 dhe Telekom i Maqedonisë në Republikën e Maqedonisë, të dedikuar posaçërisht për këtë lojë shpërblyese, me numrin e kuponit fiskal dhe datën e lëshimit të kuponit në formatin e mëposhtëm:

#xxxxx dd.mm

- Operatorët përdoruesit e të cilëve mund të marrin pjesë janë TELECOM dhe A1 Maqedoni.

- Fituesi duhet të paraqesë kuponin fiskal gjatë marrjes së shpërblimit dhe do të identifikohet me numrin e telefonit dhe kuponit fiskal, të cilin duhet të mbajë me vete dhe të tregojë në origjinal.

- Më pas, me përzgjedhje të rastësishme (me procedurë automatike, me ndihmën e softuerit) çdo të hënë do të përzgjidhen fituesit e një numri të caktuar shpërblimesh (të shpërndara proporcionalisht sipas javës), dhe për çdo shpërblim do të sigurohen dy fitues rezervë.

## **Kushtet e pjesëmarrjes në lojën shpërblyese**

### **Neni 8**

Kusht themelor për pjesëmarrje në lojën shpërblyese është që konsumatori të jetë i moshës madhore, si dhe të shpenzojë së paku 3.000 denarë në subjektin tregtar që ka konfirmuar pjesëmarrjen në lojën shpërblyese.

Lista e qiramarrësve do të publikohet në rrjetet sociale të EAST GATE MALL në Shkup, (Facebook/Instagram), si dhe në faqen e internetit.

Çdo pjesëmarrës mund të marrë pjesë me numër të pakufizuar të kuponëve fiskal, përderisa vlera e kuponit është së paku 3.000 denarë.

Kuponët, vlera e të cilave është dyfishi i minimumit, nuk përfshihen dy herë në lojë, pra pavarësisht nga vlera e shpenzuar, çdo kupon fiskal mund të dërgohet vetëm një herë.

Çdo pjesëmarrës mund të luajë në mënyrë të pakufizuara dhe të dërgojë një numër të pakufizuar mesazhesh SMS nëse i plotëson kushtet.

Çdo fitues i një shpërblimi mund të vazhdojë të luajë dhe të jetë përsëri fitues.

Një kupon fiskal i lëshuar nga një subjekt tregtar pjesëmarrës në lojën shpërblyese, por jo në vendndodhjen e EAST GATE MALL, përkatësisht është lëshuar nga e njëjta kompani por në një vend tjetër, nuk do të merret parasysh.

Organizatori rezervon të drejtën të refuzojë të gjitha kuponët fiskal që janë blerë në mënyrë të paligjshme, kopjuar, përsëritur, riprodhuar, dublikuar, shpikur ose modifikuar në çfarëdo mënyre.

Organizatori do t'i konsiderojë si të pavlefshëm kuponët e lojës shpërblyese të përfituara nga përzgjedhja e mesazheve SMS, të dhënat e të cilave nuk korrespondojnë me ato të kuponit fiskal të bashkangjitur fizikisht.

## **Fondi shpërblyes i lojës shpërblyese**

### **Neni 9**

Fondi i përgjithshëm i lojës shpërblyese është 248.200,00 denarë me TVSH të përfshirë.

Shpërblimet kryesore që do të shpërndahen në lojën shpërblyesë janë: Skuter elektrik E-SCOOTER MS ENERGY m10 nga Neptuni dhe 2 kuponë me vlerë nga Istyle. Shpërblimet kryesore janë të përfshira në fondin total të lojës shpërblyese.

Fondi i përgjithshëm i shpërblimeve:

**\*Bashkëngjitur tabela e posaçme në formatin Excel me shpërblimet e listuara.**

## **Shorti i shpërblimeve**

### **Neni 10**

Shorti do të realizohet përmes një softueri special që gjendet në qendrën tregtare EAST GATE MALL në rrugën Bellasica nr. 2 Shkup, i cili është i destinuar posaçërisht për përzgjedhjen e rastësishme të fituesve të shpërblimeve në lojërat shpërblyese, përkatësisht shorti do të realizohet nga baza e të dhënave e mesazheve të pranuar me përzgjedhje të rastësishme (elektronike).

Një komision jurie prej dy anëtarësh do të ngritet për të drejtuar lojën shpërblyese.

1. Një përfaqësues i EAST GATE MALL DOOEL import-eksport Shkup
2. Një përfaqësues i NTH MEDIA MAKEDONIJA DOOEL SHKUP

Shorti i shpërblimeve do të mbahet çdo të hënë në periudhën nga data 03.07.2023 deri më 01.09.2023 në orën 15:00 duke shpallur e telefonit të fituesit me dy shifrat e fundit të fshehura, në rrjetet sociale dhe në faqen e EAST GATE MALL.

Personi përgjegjës nga departamenti i marketingut të EAST GATE MALL do të telefonojë fituesin dhe do t'i kërkojë të identifikohet, të tregojë kuponin fiskal dhe të vijë për të marrë shpërblimin e tij.

Në short do të marrin pjesë të gjithë pjesëmarrësit (konsumatorët) që dërguan të dhënat jo më vonë se data 31 gusht 2023 në orën 23:59.

Të gjithë këta pjesëmarrës marrin pjesë në lojën shpërblyese, përkatësisht pasi të jetë dërguar një mesazh i vlefshëm SMS, ata garojnë deri në fund të lojës, duke përfshirë edhe shpërblimet kryesore.

Datat e shortit dhe orari i shpërblimeve që do të jepen në çdo short:

**10.07.2023**

East Gate Mall 5 karta-dhuratë në vlerë prej 3.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 4.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 5000 denarë.

**17.07.2023**

East Gate Mall 5 karta-dhuratë në vlerë prej 3.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 4.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 5.000 den.

**24.07.2023**

East Gate Mall 5 karta-dhuratë në vlerë prej 3.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 4.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 5.000 denarë.

**31.07.2023**

East Gate Mall 5 karta-dhuratë në vlerë prej 3.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 4.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 5.000 denarë.

**07.08.2023**

East Gate Mall 5 karta-dhuratë në vlerë prej 3.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 4.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 5.000 denarë.

**14.08.2023**

East Gate Mall 5 karta-dhuratë në vlerë prej 3.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 4.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 5.000 denarë.

**21.08.2023**

East Gate Mall 5 karta-dhuratë në vlerë prej 3.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 4.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 5.000 denarë.

**28.08.2023**

East Gate Mall 5 karta-dhuratë në vlerë prej 3.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 4.000 denarë, East Gate Mall 1 kartë-dhuratë në vlerë prej 5.000 denarë.

**01.09.2023**

Est Gate Mall 4 karta-dhuratë në vlerë prej 3.000 denarë, Istyle 2 kuponë në vlerë prej 12.000 denarë, skuter elektrik Neptun sh.p.k E-SCOOTER MS ENERGY m10.

## **Shpallja e fituesve**

### **Neni 11**

Fituesit do të shpallen brenda tri ditëve pas çdo shorti në faqen zyrtare <https://eastgatemall.mk/>.

## **Ndarja e shpërblimeve**

### **Neni 12**

Secili fitues mund të marrë kuponin për shpërblimin e tij/saj nga “Info Pika” në EAST GATE MALL dhe më pas të shkëmbejë të njëjtin kupon për prodhimet/shërbimet në pikën e shitjes së qiramarrësit që sponsorizon shpërblimin.

Datat e shortit janë:

10.07; 17.07; 24.07; 31.07; 07.08; 14.08; 21.08; 28.08; 01.09.

**Ndarja e shpërblimeve: Shpërblimet e fituara do të jepen (do të jenë në dispozicion në Info Pikën e EAST GATE MALL) brenda 10 ditëve pas çdo shpalljeje të fituesve.**

## **Marrja e shpërblimeve**

### **Neni 13**

Procedura për marrjen e shpërblimit është si më poshtë:

Departamenti i marketingut kontakton personat e përzgjedhur, të cilët i drejtojnë të marrin kuponët në Info Pikën që ndodhet në qendrën tregtare në rrugën Bellasica nr. 2 dhe atje t'i shkëmbejnë kuponët në subjektet e shitjes në EAST GATE MALL. Info Pika ka një listë të fituesve me numrat e telefonit që do të përdoren për të identifikuar fituesit.

Fituesi nga shorti mund të regjistrohet në Info Pikën e qendrës tregtare, si dhe të marrë shpërblimin brenda afatit të duhur.

Fituesi i shpërblimit duhet patjetër të jetë vetë i pranishëm për të marrë shpërblimin.

## **Njohja me lojën shpërblyese**

### **Neni 14**

Rregullat zyrtare të lojës shpërblyese do të shpallen në faqen zyrtare të internetit të EAST GATE MALL pas marrjes së miratimit nga Ministria e Financave dhe para fillimit të lojës shpërblyese.

Pjesëmarrësit e lojës shpërblyese do të mund të mësojnë për rregullat zyrtare të lojës shpërblyese në rrjetet sociale si dhe në faqen zyrtare të qendrës tregtare: [www.eastgatemall.mk](http://www.eastgatemall.mk)

Loja shpërblyese dhe fushata do të shpallen dhe komunikohen përmes të gjitha mediave publike: televizionit, radios, billbordeve, portaleve elektronike, kanaleve sociale të EAST GATE MALL, faqes së internetit të EAST GATE MALL.

## **Ndërrimi i shpërblimeve**

### **Neni 15**

Pjesëmarrësit në lojën shpërblyese nuk kanë të drejtë të kërkojnë shpërblime të një vlere më të lartë ose të një lloji të ndryshëm nga ato të përcaktuara në rregullat zyrtare nga organizatori.

Zëvendësimi i shpërblimeve me artikuj të tjerë ose ekuivalente të tjera nuk lejohet. Në asnjë rast nuk do të jepet një numër më i madh shpërblimesh se numri i caktuar.

## **Kundërshtimet**

### **Neni 16**

Çdo pjesëmarrës i pakënaqur në lojën shpërblyese që ka një kundërshtim apo ankesë në lidhje me këtë aktivitet, ka të drejtë të paraqesë një kundërshtim me shkrim te Organizatori i lojës shpërblyese dhe të marrë një njoftim me shkrim për të njëjtën brenda 10 ditëve, nga dita e paraqitjes së kundërshtimit.

Kundërshtimet dhe ankesat konsiderohen të dorëzuara në afat, nëse janë dorëzuar jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e shpalljes zyrtare të fituesit të shpërblimit.

## **Përgjegjësia**

### **Neni 17**

Pjesëmarrësi i mundshëm në këtë lojë shpërblyese i kupton rregullat dhe kushtet e lojës shpërblyese dhe pranon që ai po merr pjesë në lojën shpërblyese me vullnetin e tij të lirë.

Organizatori i lojës shpërblyese nuk jep garanci se pjesëmarrësi do të fitojë shpërblim nëse ai merr pjesë me një numër më të madh të kuponëve fiskal.

Organizatori nuk mban përgjegjësi nëse shpërblimi nuk mund të jepet ose përdoret për shkak të pamundësisë së fituesit për të marrë shpërblimin brenda afatit të caktuar për marrjen e shpërblimeve, për shkak të rrethanave të shkaktuara nga forca madhore.

## **Përdorimi i të dhënave personale**

### **Neni 18**

Për të marrë pjesë dhe për t'u regjistruar në lojën shpërblyese, pjesëmarrësit nuk kanë nevojë të japin të dhënat e tyre personale.

## **Detyrimet tatimore**

### **Neni 19**

Detyrimet tatimore për fituesit e shpërblimeve paguhen nga organizatori i lojës shpërblyese në emër dhe për llogari të fituesit. Organizatori është përgjegjës për të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet që ndërlidhen me shpërblimet.

## **Realizimi i lojës shpërblyese**

### **Neni 20**

Loja shpërblyese, pas marrjes së miratimit nga Ministria e Financave, mund të anulohet në rast të forcës madhore.

Në rast anulimi të lojës shpërblyese, Organizatori do t'i informojë menjëherë konsumatorët për anulimin e lojës shpërblyese, për arsyet e anulimit të lojës shpërblyese, si dhe për datën e anulimit duke e publikuar atë në faqen zyrtare EAST GATE MALL dhe në faqen zyrtare të EAST GATE MALL në FACEBOOK, si dhe në faqen zyrtare të EAST GATE MALL në INSTAGRAM.



## **Vlefshmëria e rregullave të lojës shpërblyese**

### **Neni 21**

Këto rregulla zyrtare janë të vlefshme nga dita e miratimit të tyre dhe do të fillojnë të zbatohen pasi Ministria e Financave të lëshojë lejen për organizimin e lojës shpërblyese dhe do të jenë të vlefshme deri në përfundim të së njëjtës. Me pjesëmarrjen në lojën shpërblyese, çdo pjesëmarrës pranon të gjitha të drejtat dhe detyrimet në këto rregulla.

## **Mosmarrëveshjet e mundshme**

### **Neni 22**

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet organizatorit dhe pjesëmarrësve në lojën shpërblyese do të zgjidhet në mënyrë miqësore dhe në rast të kontestit, gjykata kompetente në Shkup do ta zgjidhë atë në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

**Organizator i lojës shpërblyese:**

**EAST GATE MALL**

**Subjekt i shitjes** – dyqan me pikë shitjeje në EAST GATE MALL sh.p.k.